



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2163/6 prot.

Datë 10.09.2025

V E N D I M

Nr.1213/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.09.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “HTM” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-52473-06-26-2025, me objekt: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”, me fond limit 150,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.07.2025 nga autoritetkontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “HTM” SHPK, me NIPT K97006004D dhe adresë: Shkoder, Lagja Perash, Rruga Rrojej, Nr 44.

Autoriteti Kontraktor:

Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë, me adresë Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.06.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-52473-06-26-2025, me objekt: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”, me fond limit 150,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

II.2. Në datën 21.07.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 31.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. HTM	125,560,500 lekë	skualifikuar
2. BOE “ A & E” & “ Novamat“	143,000,000 lekë	kualifikuar
3. G.P.G. COMPANY	147,000,000 lekë	skualifikuar
4. DIVITECH	149,000,000 lekë	skualifikuar
5. BOE “ Eidon-Grup” & “ JUNIK“	149,069,000 lekë	skualifikuar

II.4 Në datën 06.08.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Njoftim të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt -shqyrtimi.

II.5. Operatori ekonomik “HTM ” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë: “OE HTM sh.p.k nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.8 pasi për:

- zërin Rele të e mbrojtjes sipas specifikimeve teknike nuk është paraqitur katalog në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, dhe dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë. Dëshmi të cilat vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, kërkesa të këtij kriteri.

- zërin RTU sipas specifikimeve teknike nuk është paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë. Dëshmi të cilat vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, kërkesë e këtij kriteri

-OE HTM sh.p.k nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.9 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri, në të cilin kërkohet që OE duhet të paraqesë Aurorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për shërbimin e integritetit scada të HEC Vau i Dejës të sinjaleve të impiantit të ri 10kV.”.

II.6. Në datën 11.08.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5658 dhe nr.2163/2025 prot, datë 11.08.2025, i operatorit ekonomik “HTM” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-52473-06-26-2025, me objekt: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”, me fond limit 150,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “HTM” SHPK , nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në datën 11.08.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5659 dhe nr.2163/1/2025 prot, datë 11.08.2025 për të njëjtën procedurë prokurimi.

II.8. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “*Për prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2163/2 prot., datë 12.08.2025.

II.9. Autoriteti kontraktor me shkresën nr.3693/2 prot., datë 15.08.2025 me objekt “*Vendim për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt*” *Rinovim i impiantit shpërndarës.....*” ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin e KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë, në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të LPP-së i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të ankimuesit, KPP gjen me vend të sqarojë pozitën e ankimuesit lidhur me pagesën e tarifës financiare për procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP bën me dije se ankimuesi ka aplikuar në sistemin e ankesave elektronike dy herë herë për të njëjtën procedurë prokurimi konkretisht përmes ankesave me nr. ankimi elektronik A/2025/5658 dhe nr.2163/2025 prot, datë 11.08.2025 dhe ankimi elektronik me nr. A/2025/5659 dhe nr.2163/1/2025 prot, datë 11.08.2025. Ankimuesi ka paraqitur mandat pagesë vetëm të ankesa me nr. ankimi elektronik A/2025/5658 dhe nr.2163/2025 prot, datë 11.08.2025, ndërsa për ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/5659 dhe nr.2163/1/2025 prot, datë 11.08.2025 nuk ka paraqitur mandat pagesë e si rrjedhojë statusi i saj është “*paparaqitur mandat pagesë*” dhe si e tillë do të koniderohet si ankesë pa pagesë dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP për mos plotësim të kushteve formale sipas legjislacionit për prokurimin publik në fuqi.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyetimin se: “*OE HTM sh.p.k nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.8 pasi për:*

- *zërin Rele të mbrojtjes sipas specifikimeve teknike nuk është paraqitur katalog në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, dhe dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë. Dëshmi të cilat*

vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, kërkesa të këtij kriteri.

• zërin RTU sipas specifikimeve teknike nuk është paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë. Dëshmi të cilat vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, kërkesë e këtij kriteri ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.7 “Formular i i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” , 2. “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, e modifikuar, pika 2.3.8, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë saktësisht kolonën me të dhënat teknike të ofertuar në të gjitha tabelat e paraqitura sipas Specifikimeve teknike dhe Termave të Referencës.

✚ ***Çela 10kV sipas specifikimeve teknike.***

✚ ***Reletë e mbrojtjes sipas specifikimeve teknike.***

✚ ***RTU dhe HMI sipas specifikimeve teknike.***

✚ ***Kablo TM dhe TU sipas specifikimeve teknike.***

Operatori ekonomik ofertues për sa më sipër duhet të paraqesë:

✚ Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar. Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

✚ Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike, të përkthyer në gjuhën shqipe. Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

✚ Dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë. Dëshmitë duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e e materialeve të prodhuara (lista e mësipërmë ose të ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “HTM” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Dokumentin me emërtim “2-3-8 _ _ HTM _ _ KATALOGE _ E _ TEST _ RAPORTE”
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “HTM, të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesa III, pika A, Deklaratë, është deklaruar se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentat e tenderit....

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.2.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

III.2.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në

njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4.Oferta konsiderohet e vlefshme, edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe të mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktorë, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.8. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe e produktit/mallit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kriteret për kualifikim dhe specifikime teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.8 ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë saktësisht kolonën me të dhënat teknike të ofertuar në të gjitha tabelat e paraqitura

sipas Specifikimeve teknike dhe Termave të Referencës edhe për Reletë e mbrojtjes sipas specifikimeve teknike; RTU dhe HMI sipas specifikimeve teknike, si dhe duhet të paraqesin Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe Dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi, të kryera më parë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “HTM” SHPK, për përmbushjen e kriterëve të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.2 të këtij vendimi (katalog dhe raporte testimi). Referuar raportit të auditit në SPE, Komisioni konstaton, se nga ana e KVO është vlerësuar mungesë fizike e dokumentacionit të kërkuar në përmbushje të kriterëve të sipërpërmendur, e më konkretisht KVO shprehet: *“për zërin Rele të e mbrojtjes sipas specifikimeve teknike nuk është paraqitur katalog., për zërin_zërin RTU sipas specifikimeve teknike nuk është paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare.* Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar raportit të auditit në SPE, si dhe dokumentacionit të operatorit ekonomik “HTM” SHPK të dorëzuar në SPE, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit të mësipërme, Komisioni konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues është dorëzuar dokumentacion (katalog dhe raporte testimi), në funksion të përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.8 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, por nga ana e autoritetit kontraktor nuk është marrë në shqyrtim ky dokumentacion për të vlerësuar nëse operatori ekonomik ankimues me këtë dokumentacion të dorëzuar përmbush ose jo kriteret e përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të rikthejë procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga statusi aktual në statusin e fazës së vlerësimit, dhe secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në funksion të përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.8 të dokumentave të tenderit për zërin rele dhe zërin RTU, duke evidentuar qartë dhe saktë, përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ankimues qëndron pjesërisht.

III.3.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyetimin se: *“OE HTM sh.p.k nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.9 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri, në të cilin kërkohet që OE duhet të paraqesë Aurorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për shërbimin e integritetit scada të HEC Vau i Dejës të sinjaleve të impiantit të ri 10kV.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. III.1.1. Në shtojcën nr.7 “Formular i i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” , 2. “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, e modifikuar, pika 2.3.9, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.9 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për shërbimin e integritetit në SCADA të HEC Vau Dejës të sinjaleve të impianit të ri 10kV.*

Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “HTM” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Dokumentin me emërtim “2-3-9 - _HTM - _AUTORIZIM_PRODHUESI”

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.3.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.5. Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

III.3.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*
- 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*
- 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*
- 4. Oferta konsiderohet e vlefshme, edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.3.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe të mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi

vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.3.8. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe të specifikimeve teknike, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit/mallit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kriteret për kualifikim dhe specifikime teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.9 ka kërkuar shprehimisht që Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për shërbimin e integritetit në SCADA të HEC Vau Dejës të sinjaleve të impianit të ri 10kV.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues "HTM" SHPK, për përmbushjen e kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin e përmendur në pikën III.3.2 të këtij vendimi (autorizim prodhuesi). Referuar raportit të auditit në SPE, Komisioni konstaton, se nga ana e KVO është vlerësuar mungesë fizike e dokumentacionit të kërkuar në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, e më konkretisht KVO shprehët: *"nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.9 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri"*.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar raportit të auditit në SPE, si dhe dokumentacionit të operatorit ekonomik "HTM" SHPK të dorëzuar në SPE, në përmbushje të kriterit të kualifikimit të mësipërm, Komisioni konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues është dorëzuar dokumentacion (autorizim prodhuesi), në funksion të përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, por nga ana e autoritetit kontraktor nuk është marrë në shqyrtim ky dokumentacion për të vlerësuar nëse operatori ekonomik ankimues me këtë dokumentacion të dorëzuar përmbush ose jo kriterin e përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të rikthejë procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga statusi aktual në statusin e fazës së vlerësimit, dhe secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në funksion të përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.9 të dokumentave të tenderit, duke evidentuar qartë dhe saktë, përmbushjen ose jo nga ankimuesi të këtij kriteri.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar, nenit 15 pika 1 e ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 *"Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publik"* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *"Për*

përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 15, pika 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “HTM” SHPK me numër ankimi elektronik A/2025/5659 dhe nr.2163/1/2025 prot, datë 11.08.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-52473-06-26-2025, me objekt: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”, me fond limit 150,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/5658 dhe nr.2163/2025 prot, datë 11.08.2025 të operatorit ekonomik “HTM” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
 3. Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “HTM ” SHPK
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

